



01-1040

| | | |
|--|--|-------------------------|
| | <p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p> | <p>PRISHTINA</p> |
|--|--|-------------------------|

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-138341/22 dt. 16.06.2022, të pronarëve Gani Bajraktari, Ramadan Bublica, Adnan Murtezi, Sejduallah Morina, Mehdi Thaqi, Selim Bajra, Sokol Hoda, Besim Krasniqi, Bekim Krasniqi, Asip Beqiri, Feti Delija, Adem Vrajolli, Shaip Ajeti, Salih Pajaziti dhe Arsim Krasniqi i nga Prishtina dhe “Lirimi & ACL” sh.p.k. me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të tërësisë hapsinore “F”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rrugën “Venet Bajrami” dhe “Jakov Xoxa” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunes së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 21.08.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LEJOHET** pronarëve Gani Bajraktari, Ramush Ahmetaj, Adnan Murtezi, Sejduallah Morina, Mehdi Thaqi, Selim Bajra, Sokol Hoda, Besim Krasniqi, Bekim Krasniqi, Asip Beqiri, Feti Delija, Adem Vrajolli, Shaip Ajeti, Salih Pajaziti dhe Arsim Krasniqi nga Prishtina, me investitor “Lirimi & ACL” sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810821860, me përfaqësues Hysen Haxhaj dhe Misin Thaqi, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-138341/22 dt. 16.06.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës “D” me etazhitet -2B+P+8ET, ndërtesës “E” me etazhitet -2B+P+9ET dhe ndërtesës “F” me etazhitet -2B+P+7ET, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-78489/18 dt. 11.06.2018, dhe Vendimit për plotësim ndryshimin me numër 05 Nr. 351/03-78489/18 dt. 24.08.2021, në kuadër të tërësisë hapsinore “F”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1617-0 ZK Matičan.
- II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Venet Bajrami” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 20, 22, 24, 26, 91, 93, 95, 97, 28, 30, 32, 34, 99, 101, 103, 105, 36, 38, 40, 42, 44, 107, 109, 111 dhe 113 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësisve të saja në evidencat e regjistrit kadastral.
- IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.



Ar sy e t i m

Pronarët Gani Bajraktari, Ramush Ahmetaj, Adnan Murtezi, Sejdullah Morina, Mehdi Thaqi, Selim Bajra, Sokol Hoda, Besim Krasniqi, Bekim Krasniqi, Asip Beqiri, Feti Delija, Adem Vrajolli, Shaip Ajeti, Salih Pajaziti dhe Arsim Krasniqi nga Prishtina dhe investitori "Lirimi & ACL" sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810821860, me përfaqësues Hysen Haxhaj dhe Misin Thaqi, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-138341/22 dt. 16.06.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës "D" me etazhitet -2B+P+8ET, ndërtesës "E" me etazhitet -2B+P+9ET dhe ndërtesës "F" me etazhitet -2B+P+7ET, të ndërtuara në kuadër të tërësisë hapsinore "F", të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1574-1, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351/02-78489/18 dt. 11.06.2018 dhe Vendimit për plotësim ndryshimin me numër 351/03-78489/18 dt. 24.08.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-138341/22 dt. 12.07.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Burim Bajraktari; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Arton Dautaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Raif Shatri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Berat Hasanaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Heset Hajdini; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Arban Shala, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Luan Islami, me nr. të licencës 47;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.



Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumë banesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuarit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-138341/22 DT. 21.08.2023**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,
Vazife Krasniqi



